



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**  
**Nr. 04 Datë 23.10.2020**

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT Z. ARBRON DIN VATA NGA LISTA SHUMEMËRORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË KUKËS, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 11 i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur;

**VËREN**

Me shkresën nr. 1/10 prot., datë 02.03.2020, këshilli i bashkisë Kukës ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, për arsye të dorëheqjes nga mandati i këshilltarit zj. Enkeleda Dashnor Ademi.

Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Social Punëtore Shqiptare, për këshillin e bashkisë Kukës, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 05, z. Arbron Din Vata.

Më datë 24.06.2020, z. Arbron Din Vata, kandidat i rradhës nga lista shumëemërore e subjektit Politik Partia Social Punëtore Shqiptare, këshilli bashkiak Kukës, ka sjelle formularin e vetëdeklarimit pa kërkesën përkatëse nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.



Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore të subjektit politik Partia Social Punëtore Shqiptare, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër 00334 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar z. Arbron Din Vata, në këshillin e bashkisë Kukës, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 1240 prot., datë 30.06.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1239 prot., datë 30.06.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Arbron Din Vata, në Këshillin e Bashkisë Kukës, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Kukës, z. Arbron Din Vata .

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me shkresën nr. 6442/1 prot., datë 06.07.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Arbron Din Vata, në këshillin e bashkisë Kukës, i cili rezulton me status i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli i bashkisë ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të Kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se, për kandidatin për anëtar z. Arbron Din Vata, në këshillin e bashkisë Kukës, të dhënat e të cilit nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet të vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli i bashkisë Kukës.



## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 11, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

## VENDOSA:

1. Z. Arbron Din Vata, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Kukës, të subjektit politik Partia Social Punëtore Shqiptare nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Vazhdimin e procedurave nga këshilli i bashkisë Kukës, për dhënien e mandatit, kandidatit të listës shumëmemërore z. Arbron Din Vata, të subjektit politik Partia Social Punëtore Shqiptare, për plotësimin e vendit vakant në Këshillin e Bashkisë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONER**  
**Ilirjan CELIBASHI**

